



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 08

Prishtinë, më 11 maj 2011, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi – kryetar, Behar Selimi, Mufera Şinik, Arsim Bajram, Halit Krasniqi, Haki Demolli, Armend Zemaj, Albulena Haxhiu, Ardian Gjini, Ibrahim Makolli dhe Jasmina Zhivković.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Xhevat Azemi – AKP, Lirak Brovina – AKP, Scott Bowen – AKP, Artan Canhasi dhe Vlora Marmullakaj – EULEX, Sylë Ahmeti – Kosova sot, Driton Selmanaj – KDI, Natyra Krasniqi - KDI dhe Fixhrije Dragaj – praktikant.

Nga Stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 04.04.2011,
3. Shqyrtimi i raportit vjetor i Agjencisë Kosovare të Pronës, për vitin 2010,
4. Shqyrtimi i propozimit për emërimin e anëtarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës, sipas përfundimit të Kryesisë, nr. 04-P-023/k;
5. Shqyrtimi i propozimit të grupit të punës lidhur me kërkesën e Gjykatës Kushtetuese;
6. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 04. 04. 2011

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 04. 04. 2011, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit vjetor i Agjencisë Kosovare të Pronës për vitin 2010

Kryetari – E hapi mbledhjen e Komisionit, i përshëndeti përfaqësuesit e Agjencisë Kosovare të Pronës, ftoi z. Xhevat Azemi ta prezantojë raportin.

Xhevat Azemi- Ai theksoi se AKP –ja është themeluar në vitin 2006. Agjencia është organ i pavarur e cila bazën e themelimit e ka në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Mandat i agjencisë është zgjedhja e kontesteve për pronën e paluajtshme private, konteste që janë të lidhura me luftën, gjegjësisht në periudhën shkurt 1998- qershor 1999, kryesisht për pronat bujqësore dhe komerciale, por pa i përjashtuar edhe pronat banesore. Përveç këtij mandati ajo e ka trashëguar edhe një pjesë të mandatit të ish- drejtorisë për çështje pronësore dhe banesore e cila ka qenë e themeluar në vitin 1998- 1999, zbatimi i vendimeve të pazbatuara administrimi i pronave që kanë qenë nën administrim të saj dhe zbatimi i skemës të qirasë. Në strukturën organizative Agjencia ka tri trupa kryesore: sekretarin ekzekutiv, bordin mbikëqyrës, i cili ka pesë anëtarë, zgjedhjen e kërkesave e bën Komisioni për kërkesa pronësore, i cili përbëhet prej tre anëtarëve. Në vazhdim ai dha shifra rreth kërkesave të paraqitura dhe vendimeve të Komisionit. Përmendi mbështetjen e Agjencisë, përmes UNHCR-it, kemi qasje në dokumentacionin kadastral që gjendet në Serbi. Gjatë vitit 2010 janë bërë raporte të verifikimit të dokumenteve për 5275 kërkesa dhe pas kësaj përgatitet raporti i përgjithshëm që i prezantohet Komisionit për kërkesa pronore, i cili vendos për kërkesa, ku gjatë vitit 2010 janë vendosur gjithsej 5380.

Ndër çështjet tjera përmendi vështirësitë e paraqitura në punën e Agjencisë, sidomos në pjesën veriore të Kosovës.

Kryetari- E falënderoi për prezantimin duke shtuar se puna e Agjencisë është një punë shumë komplekse, duke pasqyruar edhe aktivitetin dhe administrimin e pronës private që është një e drejtë themelore e njeriut. Mendoj që është një punë që duhet ta rritë efikasitetin e vet në pjesë të caktuara të territorit të Kosovës duke pasur si prioritet pjesën veriore të Kosovës.

Arsim Bajrami- Theksoi se themelimi i kësaj agjencie ka pasur një fillim të rëndësishëm politik dhe është tipik për vendet e dala nga lufta, ku çështjet e pronës janë gjithmonë çështje kontestuese. Edhe kjo agjenci ka ardhur edhe si proces normal i përfundimit të punës së drejtorisë së banesave, ose atë që e njohim në arbitrazh, ka trashëguar mandatin e tij, ka bazë kushtetuese, sepse me kushtetutë i kemi dhënë statusin e një Agjencie të pavarur. Ky organ është midis organit administrativ dhe gjykatës, është një organ që nuk e kanë në shumë vende të tjera, sepse shumë nga kontestet që zgjidh kjo agjenci në një situatë normale do të duhej t'i bënte gjykata, çështjet pronësore, çështjet e posedimit, pengim- posedimi, të vërtetimit të drejtave pronësore, janë çështje tipike për gjykatat. Pyeti: edhe sa kohë mendoni që keni nevojë për udhëheqje ndërkombëtare, si dhe a keni bërë përpjekje që të keni memorandum mirëkuptimi me EULEX- in dhe faktorët e tjerë që të ju ndihmojnë, për çështjet që i ngritët për pjesën veriore? Ai shtoi se sa mendoni që do të vazhdojë në opinion të krijohet bindje që kjo agjenci është vetëm për të drejtat e serbëve, sepse është krijuar bindje se në këtë agjenci paraqesin kërkesa vetëm serbët. Unë e di që edhe shqiptaret paraqesin kërkesa që u janë mohuar të drejtat pronësore, sidomos në veri. Ai tha se

numri më i madh i kërkesave ka të bëjë me qytetarët e Kosovës që nuk jetojnë në Serbi, madje në këtë fushë ka pasur shumë keqpërdorime.

Armend Zemaj- Duke u ndërlidhur me parafolësin tha se gjatë paraqitjes së raportit nuk e kam parë bashkëpunimin tuaj konkret me gjykatat, deri ku keni arritur nivelin e bashkëpunimit me policinë? E pashë që keni bashkëpunim, por me gjyqësinë nuk pashë diçka konkrete. Në vitin 2008 është miratuar ligji për AKP- në dhe mendoj që rregullorja e UNMIK- ut është suprimuar me këtë ligj, ndërsa gjatë gjithë raportit pashë që ju thirrreni prapë në ato nenet e caktuara të asaj rregulloreje, prandaj kërkoi sqarim, a përdorni standarde të dyfishta, d.m.th. që në një pjesë të Kosovës të punoni me rregullore të UNMIK- ut ndërsa në pjesën tjetër të zgjidhen këto konteste gjyqësore me ligjin për themelimin e Agjencisë Kosovare të Pronës. Ai tha se kjo është një shqetësim, si Komision kishte qenë mirë që në të ardhmen të mbajmë ndonjë takim dhe të bisedojmë për amendamentimin e këtij ligji dhe të definohen kompetencat e kësaj agjencie.

Albulena Haxhiu- Ajo tha se në analizat që i kemi bërë këtij raporti shihet se kjo agjenci është më së paku në interes të qytetarëve të Kosovës, sepse nuk e merr për bazë kontestin historik e politik, e bile as atë të drejtave të njeriut. Sa i përket raportit kam parë një mungesë të transparencës, kam parë lëvizjet që janë bërë me stafin, kam parë edhe dështimet që i kanë pranuar edhe vetë zyrtaret e KPA- së. Vërejtje tjera do t'i paraqesë në seancë plenare.

Ardian Gjini- Ai tha se kam qenë i përfshirë edhe në fillimin e punës së Agjencisë, besoj që është bërë një punë e mirë, edhe tani po bëhet një punë e mirë. Çështja e pronës pas luftës në Kosovë ka qenë shumë problematike, ngase nuk mund të paramendojmë të jemi një shoqëri me sundim të ligjit nëse cenohet prona private, ka qenë e pamundur t'i drejtohesh gjykatave për shkak numrit të madh të rasteve. Për një kohe shumë të gjatë kanë qenë qytetarët e Kosovës që janë shpronësuar, meqenëse kjo agjenci e përfundon mandatin e saj, do të doja të dija: a ka ndonjë ide se kur mund të ndodh kjo, a ka ndonjë ide se çka do të ndodh me Agjencinë, kush do ta marrë përsipër menaxhimin e pronave që janë në menaxhim të Agjencisë në momentin kur ajo të përfundojë së ekzistuari.

Haki Demolli- Në fjalën e tij ju referua faqes 22 të raportit, ku është një fjali që ka të bëjë me diskriminimin e bartësve të të drejtës pronësore, i interesonte të dijë kush ka ndikuar në këtë diskriminim, respektivisht, cilat kanë qenë aktivitetet dhe çka është ndërmarrë nga ana e Agjencisë për zbutjen e pasojave të diskriminimit? Ndërsa në faqen 31-32 të raportit keni potencuar ngjarjet kryesore gjatë vitit 2010, e në ngjarjet e tjera keni shënuar disa të dhëna, disa të hyra financiare që janë realizuar nga donatorët e ndryshëm diku 680 mijë euro, kurse në buxhet keni një shumë, nëse nuk gaboj 1 milion e 7 qind mijë, pse është kjo mos përputhje? Ai po ashtu kërkoi sqarim lidhur me çështjen e qiradhënies, ku në raport keni paraqitur të inkasuara mbi 2 milionë e 5 qind mijë euro, në buxhetin e vitit 2010 nuk ka të dhëna për këto mjete?

Pyetjeve të anëtarëve të Komisionit ju përgjigj drejtori i AKP-së Xhevat Azemi duke thënë sqarime për secilën nga pyetet e adresuara.

Pas diskutimeve për këtë pikë të rendit të ditës, Kryetari e vuri në votim që raporti i punës të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 10,

Kundër këtij propozimi ishte Albulena Haxhiu, për faktin se mandati i kësaj agjencie rrjedh nga plani i Ahtisaarit, përderisa funksionon me këtë bazë ligjore, nuk e përkrahim.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion me 10 vota “për” dhe 1 votë “kundër”, nxori këtë:

R e k o m a n d i m

Të shqyrtohet dhe të miratohet Raporti i punës i Agjencisë Kosovare të Pronës, për vitin 2010.

4. Shqyrtimi i propozimit për emërimin e anëtarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës, sipas përfundimit të Kryesisë, nr. 04-P-023/k

Kryetari- I njoftoi me propozimin e këshillit drejtues të institutit gjyqësor për emërimin e Bedri Bahtirit për anëtar të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor. Pyeti nëse dikush ka vërejtje rreth propozimit?

Haki Demolli- Theksoi se bëhet fjala për kandidatin Bedri Bahtiri, me të cilin kam pasur rastin të punoj edhe në Ministri të Drejtësisë. Mendoj që i plotëson të gjitha kushtet dhe kriteret, prandaj pajtohem që ta procedojmë me tutje.

Kryetari- Duke u ndërlidhur me parafolësin tha se kandidati i plotëson kushtet, mirëpo kemi një problem ngase personi në fjalë ka edhe 4- 5 vende të tjera pune dhe nuk mund ta dijë sa mund të jetë efikas.

Lidhur me propozimin në fjalë nuk kishte vërejtje të tjera dhe u kërkua deklarimi anëtarëve.

***Kryetari** konstatoi se Komisioni për Legjislacion, lidhur me këtë çështje në mënyrë unanime nxori këtë*

R e k o m a n d i m

Të emërohet Bedri Bahtiri anëtar i Këshillit Drejtues i Institutit Gjyqësor të Kosovës.

5. Shqyrtimi i propozimit të grupit të punës lidhur me kërkesën e Gjykatës Kushtetuese

Haki Demolli- Në emër të grupit të punës, i cili ishte në përbërje Haki Demolli, Arsim Bajrami dhe Albulena Haxhiu, tha se kemi mbajtur grupin punues, ku kemi diskutuar rreth përgjegjës të cilën do t'ia dërgojmë gjykatës kushtetuese, lidhur me çështjen që jemi ngarkuar me përfundimin e Kryesisë së Kuvendit nr. 04-P-012/k. Si grup punues kemi menduar që është e mjaftueshme kjo përgjigje që keni para vetes dhe jemi për atë që të procedohet tutje.

Albulena Haxhiu- Duke u ndërlidhur me parafolësin tha se unë nuk e di qysh funksionojnë grupet punuese, por mënyra qysh ka funksionuar grupi që e kemi pasur për këtë çështje është ndër ma të këqijat. Unë kom bërë një analizë diku rreth 7- 8 ditë para këtij takimi dhe faktet që i kam mbledhur, nuk janë marrë parasysh. Kam qenë kundër asaj përgjigje edhe në grupin e punës dhe kisha dashur që në përgjigjen që e procedoni të përfshihen vërejtjet e mija.

Haki Demolli- Sa i përket organizimit të takimit, unë si kryesues i grupit, jam takuar me administratën dhe pasi e kemi përpiluar përgjigjen e kemi analizuar dhe ia kemi dërguar anëtarëve të grupit të punës, dhe kemi mbajtur takimin me rregull. Në përgjigje, ne kemi vlerësuar se dispozita e theksuara nuk janë në kundërshtim me dispozitat e kushtetutës, ndërsa Albulena ka bërë një analizë dhe ne si grup e kemi dëgjuar, dhe kemi marrë vendim për këtë version që tani ju e keni.

Armend Zemaj- Theksoi se ligji nuk ka të bëjë me shkeljen e të drejtave të njeriut dhe kjo është e garantuar edhe me Kushtetutë dhe çështje të tjetër është se ky ligj ka kaluar me shumicë votash.

Pas diskutimeve për këtë pikë të rendit të ditës, kryetari e vuri në votim përgjigjen e grupit të punës, që e njëjta t'i procedohet Gjykatës Kushtetuese.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 9,

Kundër këtij propozimi ishin Behar Selimi dhe Albulena Haxhiu.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion me 9 vota “për” dhe 2 vota “kundër”, nxori këtë:

PËRFUNDIM

Komisioni e mbështeti përgjigjen e përgatitur nga grupi punës dhe vendosi që kjo përgjigje t'i procedohet Gjykatës Kushtetuese.

6. Të ndryshme

Armend Zemaj- I informoi anëtarët që nuk janë pjesë e Nënkomisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore, se të premten dhe të shtunën do jemi në një punëtori për hartimin e rregullores në Prevallë “Sharr” të Prizrenit, nëse ndokush prej anëtarëve të Komisionit shpreh gatishmëri mund të marrë pjesë.

Arsim Bajrami- Tha se ky nënkomision është brenda Komisionit të ligjeve dhe do të doja të harmonizohet pak me të. Ai po ashtu informoi se të premten është mbledhja e tretë e Komisionit për ndryshime kushtetuese dhe do t'i lusja përfaqësuesit e të gjitha partive politike që deri të premten t'i bëjnë propozimet për ekspertë.

Kryetari- Tha se Nënkomisioni për Mandate, Rregullore dhe Imunitete dihet që është pjesë e Komisionit për Legjislacion dhe do të ishte mirë raportimi pak më shpesh në Komision.

Mbledhja përfundoi në orën 12:40.

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Arben Gashi